

Vendim nr. 38 datë 22.02.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 22.02.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **AGIM ELEZI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. (11-2017-453)38/564, datë 01.02.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 10-2017-2176(235), datë 25.09.2017 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2022-1053, datë 13.09.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, pika 2, 17, 18, 33, pika 1, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 2395 të vitit 2015, në ngarkim të shtetasit Agim Elezi (*kërkuesi*), për veprat penale “Falsifikimi i vulave, stampave dhe formularëve” dhe “Pengimi i ekzekutimit të vendimit të gjykatës”, të parashikuara nga nenet 190, pika 1 dhe 320 të Kodit Penal (KP). Sipas organit të akuzës, edhe pse ka qenë në dijeni të vendimit nr. 1205, datë 30.05.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, kërkuesi, në vitin 2014, ka aplikuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit duke përdorur dokumente e vula të falsifikuara në emër të shoqërisë “Amal” sh.p.k., ndërsa ka kërkuar heqjen si administratore të saj të shtetases L.H.

2. Vendimi gjyqësor i referuar nga organi i akuzës lidhet me një mosmarrëveshje mes kërkuesit dhe shtetases L.H. për shitjen e kuotave që ai zotëronte në shoqërinë “Amal” sh.p.k., shoqëri kjo që ka marrë me koncension hidrocentralin e Xhyrës, Librazhd. Për vlefshmërinë e këtyre kontratave, referohet nga aktet se kërkuesi ka paraqitur padi, për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 539, datë 01.02.2010, ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të shitblerjes dhe kthimin e palëve ndërgjyqëse në gjendjen e mëparshme lidhur me shitjen e kuotave të shoqërisë “Amal” sh.p.k. Ky vendim është ndryshuar me vendimin nr. 1205, datë 30.05.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Mbi rekursin e kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-153, datë 20.01.2012, ka vendosur mospranimin e tij.

3. Në kuadër të procedimit penal të filluar ndaj kërkuesit, ai është marrë i pandehur duke u akuzuar për kryerjen e veprave penale “Falsifikimi i vulave, stampave dhe formularëve” dhe “Pengimi i ekzekutimit të vendimit të gjykatës”, të parashikuara nga nenet 190, pika 1 dhe 320 të KP-së. Në përfundim të hetimeve paraprake, në datën 28.01.2016 prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim.

4. Në vijim kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal kundër prokurorit të çështjes dhe drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, me pretendimin se ata, duke dërguar për gjykim çështjen penale kundër tij edhe për akuzën e kryerjes së veprës penale “Pengimi i ekzekutimit të vendimit të gjykatës”, të parashikuar nga neni 320 i KP-së, kanë shpërdoruar detyrën në rrethanat kur kjo vepër penale nuk ekzistonte, pasi ekzekutimi i vendimit

civil nr. 1658, datë 25.07.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, ishte pezulluar nga Gjykata e Lartë me vendimin e saj nr. 79, datë 02.03.2015. Sipas kërkuessit, megjithëse në dijeni të këtij fakti, prokurori i çështjes ka dërguar për gjykim çështjen penale kundër tij edhe për këtë akuzë. Ai ka pretenduar, gjithashtu, se prokurori nuk ka kryer veprimet e nevojshme duke sekuestruar fashikullin e gjykimit ku ai është i pandehur dhe më tej të vlerësonte faktet e provat në lidhje me kallëzimin.

5. Vendimet gjyqësore të referuara nga kërkuessi lidhen me një mosmarrëveshje të lindur nga deklarata noteriale e datës 23.01.2007, me të cilën kërkuessi dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar se shitja e kuotave të shoqërisë “Amal” sh.p.k. në favor të shtetas L.H. përmban në vlerë edhe pasurinë e paluajtshme truall ose tokë arë dhe çdo pasuri tjetër që i takon shoqërisë, si edhe vlerën në lekë që kanë marrë nga shitja e pjesëve të kapitalit. Për këtë deklaratë noteriale referohet nga aktet se shtetasja L.H. i është drejtuar gjykatës duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 1658, datë 25.07.2011, ka vendosur pranimin e padisë, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes mes palëve ndërgjyqëse nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 23.01.2007 dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 10-2014-95/49, datë 16.01.2014 të Gjykatës së Apelit Durrës. E vënë në lëvizje me rekursin e palës së paditur në procesin gjyqësor, mbi bazën e kërkesës së kësaj të fundit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 79, datë 02.03.2015, ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të mësipërme.

6. Ndërkohë, materialin kallëzues të kërkuessit Prokuroria e Përgjithshme ia ka dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ku kallëzimi është regjistruar me nr. 2831 të vitit 2016.

7. Pas kryerjes së veprimeve verifikuese, bazuar në nenin 290, pika 1, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), me vendimin e datës 26.10.2016, prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. 2831 të vitit 2016. Prokurori ka çmuar se çështja penale nuk mund të fillonte, sepse fakti i kallëzuar nuk përmbante elementet e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Ai ka arsyetuar se marrja e vendimit në lidhje me një çështje objekt hetimi është kompetencë e prokurorit dhe si e tillë nuk përmban elementet e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”. Vendimi i dërgimit të çështjes për gjyq është marrë në

përputhje me kërkesat e ligjit, mbi bazën e provave të administruara gjatë hetimit, si dhe bindjes së brendshme të krijuar. Sipas vendimit të mosfillimit, nëse kallëzuesi nuk është dakord me akuzën e ngritur ndaj tij, ai ka të gjitha mjetet e nevojshme procedurale që t'i paraqesë pretendimet dhe provat penale kundër veprës penale "Pengimi i ekzekutimit të vendimit të gjykatës", të parashikuar nga neni 320 i KP-së, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku çështja është në shqyrtim.

8. Ndaj vendimit të mësipërm të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, bazuar në nenin 291 të KPP-së, kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatë në datën 09.11.2016.

9. Me vendimin nr. (11-2017-453) 38/564, datë 01.02.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur: "*Rrëzimin e kërkesës nr. 38/564 regjistri, datë regjistrimi 09.11.2016, që i përket kërkuetit Agim Elezi, me objekt "Ankim kundër vendimit "Për mosfillimin e procedimit penal" nr. 2831 të vitit 2016 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, si të pabazuar në prova dhe në ligj"*". Gjykata ka vlerësuar të drejtë, të bazuar në ligj e prova vendimin e prokurorit, i cili, sipas saj, ka ushtruar kompetencat e tij vendimmarrëse në bazë dhe për zbatim të ligjit procedural penal, duke mos gjetur në veprimtarinë e tij veprime në kundërshtim me ligjin që të kishin cenuar interesat e kallëzuesit. Ajo ka konstatuar se nga ana e prokurorit ishin kryer verifikimet e nevojshme për arritjen e një konkluzioni të drejtë ligjor në lidhje me pretendimet e kallëzuesit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

10. Me vendimin nr. 10-2017-2176 (235), datë 25.09.2017, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me arsyetimin se kërkesa ankimore e kallëzuesit është e pabazuar në prova e ligj dhe me të drejtë është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë. Sipas gjykatës së apelit, prokurori ka kryer veprimet e nevojshme dhe të domosdoshme procedurale, për rrjedhojë ato konsiderohen të plota, ndaj nuk kishte arsye ose shkak për urdhërimin e kryerjes së hetimeve. Ajo ka vlerësuar se fakti i kallëzuar jo vetëm që nuk parashikohej nga ligji si vepër penale, por dilte qartë se ai nuk ekzistonte. Kërkuesi nuk ka qenë dakord edhe me këtë vendim duke paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

11. Me vendimin nr. 00-2022-1053, datë 13.09.2022, në dhomë këshillimi, bazuar në nenet 433 dhe 441, pika 1, shkronja "a", të KPP-së, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk ai përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432, pika 1, të KPP-së.

12. Me kërkesën e datës 13.01.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit të saj.

II

Pretendimet e kërkuetit

13. **Kërkuesi** ka parashtruar, në mënyrë të përmblëdhur, se i është cenuar e drejta për proces të rregullt, në drejtim të:

- 13.1. *Parimit të paanshmërisë*, pasi anëtarët e trupit gjykues të gjykatës së apelit, që kanë shqyrtuar ankimin e tij, kanë dhënë më parë disa vendime në çështje civile dhe penale ku kërkuesi ka qenë palë, çështje këto që lidheshin me vjedhjen nëpërmjet falsifikimit të hidrocentralit Xhyrë, Librazhd, i rehabilituar nga ai si pronar i truallit.
- 13.2. *Së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t`u dëgjuar*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi në një kohë kur duhej ta kalonte atë për shqyrtim në seancë gjyqësore me qëllim për të dëgjuar palët dhe për t`ia nënshtruar çështjen debatit gjyqësor, ose t`i njoftonte ato për të paraqitur parashtrimet me shkrim. Çështja është regjistruar në atë gjykatë në vitin 2017 dhe janë tejkaluar të gjitha afatet e gjykimit, ndaj njoftimi i palëve ishte i detyrueshëm. Në këtë mënyrë është cenuar edhe parimi i kontradiktoritetit.
- 13.3. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykata e shkallës së parë bazohet mbi një vendimmarrje të gjykatës civile për të rënduar rrethanat e kërkuetit si kallëzues. Ai është akuzuar për një vepër penale pa pasur asnjë provë dhe pa pasur procesverbal nga përmbaruesi gjyqësor. Ky është shkak për kthimin e çështjes për vijimin e hetimeve. Ky parim është cenuar edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili është shprehur se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432, pika 1, i KPP-së, në një kohë kur në të si shkaqe janë ngritur pretendime për shkelje të rënda procedurale.
- 13.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në rekurs nga kërkuesi në lidhje me cenimin e parimit të paanshmërisë nga gjyqtarët e gjykatës së apelit.

- 13.5. *Parimit të sigurisë juridike* në drejtim të besueshmërisë së individit të shteti, pasi kërkuuesi merret i pandehur për vepra penale, për të cilat nuk ka dyshime të arsyeshme se janë konsumuar.
- 13.6. *Standardit të gjykatës së caktuar me ligj*, i cili, në gjykimin që zhvillohet në Gjykatën e Lartë, lidhet me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të marra nga gjykatat më të ulëta.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuessit

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

15. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriterë paraprakë të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kriterëve që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

16. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji vlerëson se kërkuuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

17. Kolegji vëren se kërkuuesi plotëson edhe kriterin e shterimit të mjeteve juridike, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Ai i është drejtuar Gjykatës me ankim

kushtetues individual pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë e substancë dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjykimit të zakonshëm.

18. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, Kolegji vëren se kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 13.01.2023, ndërsa vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i datës 13.09.2022, pra kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

19. Për sa i takon legjitimitetin *ratione materiae*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që ushtron Gjykata nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor (shih vendimin nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Kolegji vëren se, në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, kërkuuesi ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë është bazuar mbi një vendimmarrje të gjykatës civile për të rënduar rrethanat e tij si kallëzues. Ai është akuzuar për një vepër penale pa pasur asnjë provë dhe pa pasur procesverbal nga përmbartuesi gjyqësor, çka përbën shkak për kthimin e çështjes për vijimin e hetimeve. Sipas kërkuarit, ky parim është cenuar edhe nga Kolegji Penal, i cili është shprehur se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432, pika 1, i KPP-së, në një kohë kur në të si shkaqe janë ngritur pretendime për shkelje të rënda procedurale.

21. Gjykata ka theksuar gjatë jurisprudencës së saj se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (shih vendimet nr. 10, datë 12.04.2022, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të

çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Kolegji vlerëson se këto pretendime të kërkuarit janë me natyrë ligjore dhe kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe zbatimit të ligjit, të cilat, si rregull, janë atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues. Kërkuari nuk ka arritur ta ngrejë këtë pretendim në nivel kushtetues, duke mos arritur të argumentojë se si vendimet gjyqësore të kundërshtuara, që kanë shqyrtuar ankimin kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e paraqitur prej tij, kanë cenuar parimin kushtetues të prezumimit të pafajësisë, i cili gjen zbatim gjatë procesit penal, i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë.

23. Kërkuari ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e parimit të paanshmërisë nga gjyqtarët e gjykatës së apelit, pasi anëtarët e trupit gjykues që kanë shqyrtuar ankimin e tij, kanë dhënë më parë disa vendime në çështje civile dhe penale ku ai ka qenë palë, çështje këto që lidheshin me vjedhjen nëpërmjet falsifikimit të hidrocentralit Xhyrë, Librazhd, i rehabilituar nga ai si pronar i truallit.

24. Kolegji vlerëson se edhe pse ka barrën e provës në këtë drejtim, kërkuari jo vetëm që nuk ka përcaktuar se cilave procese gjyqësore u referohet, por as nuk ka arritur të provojë se pjesëmarrja e gjyqtarëve në shqyrtimin e ankimit të tij është bërë në kundërshtim me dispozitat procedurale përkatëse apo se cilat janë ato sjellje ose veprime që ngrenë dyshime për respektimin e parimit të paanshmërisë në aspektin subjektiv ose objektiv të tij. Përkundrazi, argumentet e parashtruara nga kërkuari janë formuluar në mënyrë të përgjithshme. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim, pasi nuk është ngritur në nivel kushtetues.

25. Kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike, në drejtim të besueshmërisë së individit të shteti, me argumentin se ai merret i pandehur për vepra penale për të cilat nuk ka dyshime të arsyeshme se janë konsumuar. Ai ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e standardit të gjykatës së caktuar me ligj, me argumentin se gjykimi që zhvillohet në Gjykatën e Lartë lidhet me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të marra nga gjykatat më të ulëta. Në lidhje me këto pretendime, Kolegji vëren se kërkuari, përveç sa është parashtruar më sipër, nuk ka sjellë asnjë argument në mbështetje të tyre, duke mos arritur t'i ngrejë ato në nivel kushtetues, për rrjedhojë, duke mos arritur të provojë cenimin e të drejtave të tij kushtetuese.

26. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuessit, që kanë të bëjnë me cenimin e të drejtës së mbrojtjes dhe së drejtës për t'u dëgjuar, si dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Penal, ato *prima facie* janë me natyrë kushtetuese, për rrjedhojë do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t'u dëgjuar

27. Sipas kërkuessit, Kolegji Penal e ka shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi në një kohë kur duhej ta kalonte atë për shqyrtim në seancë gjyqësore me qëllim për të dëgjuar palët dhe për t'ia nënshtruar çështjen debatit gjyqësor, ose t'i njoftonte ato për të paraqitur parashtrimet me shkrim. Çështja është regjistruar në atë gjykatë në vitin 2017 dhe janë tejkaluar të gjitha afatet e gjykimit, ndaj njoftimi ishte i detyrueshëm. Për rrjedhojë, sipas tij, është cenuar edhe parimi i kontradiktoritetit.

28. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në lidhje me shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e rekursit. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Referuar dispozitave procedurale që zbatohen për shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë, sipas nenit 433 të KPP-së: “1. Rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, si dhe kur Gjykata e Lartë çmon se çështja nuk duhet të shqyrtohet prej saj, sipas përcaktimeve të paragrafit 1, të nenit 432, të këtij Kodi. 2. Mospranimi i rekursit vendoset nga një trup gjykues me tre gjyqtarë në dhomën e këshillimit.”. Kurse sipas

nenit 436/a, pika 1, të KPP-së “Shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.”. Në lidhje me rregullat e njoftimit në atë gjykatë, sipas nenit 436, pika 3, të KPP-së: “Sekretaria e gjykatës njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara. Kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara apo të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa.”.

30. Kolegji, referuar rrethanave konkrete të çështjes në shqyrtim, konstaton se kërkuesi është pala që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me anë të rekursit, në të cilin ka parashtruar shkaqet për prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Nga të dhënat e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rubrika “Çështje të shpallura për gjykim”, për kategorinë “Çështje penale”, nënrubrika “Për shqyrtim në dhomë këshillimi”, rezulton se në datën 12.07.2022 është shpallur lista e çështjeve për shqyrtim në datën 13.09.2022, si dhe përbërja e trupit gjykues për çdo çështje. Në këtë listë pasqyrohet edhe çështja e kërkuesit. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale të zbatueshme për njoftimin e palëve dhe publikimin e datave të shqyrtimit të çështjeve në atë gjykatë.

31. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe asaj për t’u dëgjuar është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

32. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në rekurs për cenimin e parimit të paanshmërisë nga gjyqtarët e gjykatës së apelit, ka cenuar edhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

33. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në

tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Zbatimi i këtij standardi vlerësohet rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimin nr. 28, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e marra nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, Gjykata ka theksuar se arsyetimi i kufizuar i këtyre lloj vendimesh nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, është tregues i faktit se kërkuuesi nuk ka ngritur asnjë nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 40, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata ka mbajtur qëndrimin se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime, të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to. Po në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se duke mos marrë përgjigje për pretendimet me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, kërkuuesit i cenohet jo vetëm standardi i arsyetimit, por edhe e drejta e aksesit dhe ajo ankimit substancial, në kuptim të neneve 42 dhe 43 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 13, datë 09.03.2021; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Duke verifikuar respektimin e këtyre standardeve në çështjen konkrete, Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë përmban të dhënat e palëve, rrethanat e çështjes, arsyetimin dhe vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta, pretendimet e ngritura në rekurs, si dhe pjesën arsyetuese ku gjykata mbështet qëndrimin e saj të shprehur në dispozitiv. Argumentet e pjesës arsyetuese janë të bazuara e të lidhura logjikisht dhe formojnë një përmbajtje koherente.

Vendimi nuk rezulton të jetë kontradiktor, alogjik, i pamjaftueshëm, apo me kundërthënie ose në mungesë të elementeve formale të parashikuara nga dispozitat ligjore dhe standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Në pjesën hyrëse të vendimit janë paraqitur rregullisht pretendimet e kërkuarit në rekurs, ndërsa në pjesën arsyetuese Kolegji Penal ka vlerësuar se pretendimet e ngritura në rekurs nuk iu referohen shkaqeve të parashikuara nga neni 432, pika 1, i KPP-së dhe se pjesa e pretendimeve që lidhet me vlerësimin e provave del jashtë juridiksionit ligjor të Gjykatës së Lartë. Kurse pretendimet për kryerjen e veprimeve hetimore janë vlerësuar si të pabazuara, pasi gjykatat e zakonshme kanë verifikuar plotësimin nga prokurori të të gjitha veprimeve të domosdoshme, verifikuese-mbështetëse të disponimit për mosfillimin e procedimit.

37. Kolegji verën se kërkuari, në thelb të pretendimit për cenimin e parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor, ka parashtruar se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të tij të ngritur në rekurs për cenimin e parimit të paanshmërisë, për shkak se anëtarët e trupit gjykues që kanë shqyrtuar ankimin e tij në gjykatën e apelit, kanë dhënë më parë disa vendime në çështje civile dhe penale ku kërkuari ka qenë palë.

38. Në jurisprudencën kushtetuese është vlerësuar se paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës, kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por edhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 6, datë 02.03.2018; nr. 46, datë 19.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në funksion të respektimit të këtij parimi, neni 15 i KPP-së ka përcaktuar rastet e papajtueshmërisë së gjyqtarit për shkak të pjesëmarrjes së tij në procedim.

39. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji rithekson se pretendimet e kërkuarit në këtë drejtim janë të përgjithshme (*shih paragrafin 24 më sipër*) dhe ai as në rekurs, as në ankimin kushtetues individual nuk ka arritur të provojë se gjyqtarët që kanë shqyrtuar çështjen e tij në gjykatën e apelit kanë marrë pjesë në gjykim në kundërshtim me dispozitat procedurale përkatëse që përcaktojnë rastet e papajtueshmërisë, apo se kanë cenuar parimin e paanshmërisë në aspektin subjektiv ose objektiv të tij.

40. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se thjesht ngritja e një pretendimi të tillë në rekurs, edhe pse *prima facie* me natyrë kushtetuese, të pambështetur në ligj dhe në prova, nuk e detyron

Gjykatën e Lartë që të duhet ta marrë në shqyrtim dhe ta arsyetojë atë. Arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë nuk cenon standardin e arsyetimit në kuptimin kushtetues, kur ajo gjykatë nuk i ka kthyer përgjigje të detajuar çdo pretendimi të ngritur në rekurs. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është haptazi i pabazuar.

41. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.